



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.27/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës IRDK, me seli në Pejë, ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE) me seli në Gjakovë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.06.2026, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PALEJUAR ankesa ZP.Anr.27/2026 e datës 05.06.2026 e paraqitur nga Subjekti Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës IRDK, me seli në Pejë, e paraqitur kundër Veton Berisha, kryetar i Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE) me seli në Gjakovë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Me datë 05.06.2026 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik IRDK me të cilën pretendon se më datë 01.06.2025, Subjekti Politik IRDK është vënë në dijeni se Veton Berisha, kryetar i PLE, ka komunikuar privatisht me mbështetësin dhe aktivistin e IRDK-së, Ibrahim Haliti, në lidhje me kryetarin e IRDK, Elbert Krasniqi, ku ka deklaruar se: *"...tana këto pa kënaqësi janë kanë për këto vite, tash këta të mira.....(..) Qeta janë që pesë gjashtë vjet, qeta i ke pasë ministra edhe tregom ti mu kur ka ardhë ministri me të pa ty, për këto pesë gjashtë vjet Qysh me provu hajnin, a u kon hajn ky Për ty? S'nuk është që je i ri se duhet me dit çka ki bërë. Tashti po provon hajnin, domethënë po i bashkangjitesh hajnit? Është marre se dëmton një popull, po ia jap mundësinë hajnit, me ardhë mbas sa vjetësh, me të keq përdorur ty në vota edhe vetë ke thënë që është hajn Elberti, kqyr çka ki shkrujt A o hajn a nuk o hajn, shoku jem? Po a jo. Keq, shumë keq. Po qata s'ecim na si popull, me ju bashkangjit hajnit, tash është marre. Ku o interesi këtu? Domethënë, me ndejt me hajna, me rrit hajnat, me me përfitu prej hajnav, me u bërë me ata, të njëjtë si ata. Më fal, po s'shkruaj, se e kreve me ty, Kam menduar qëje djalë i meçem. Djalë që e din, po mbas shtatë, shtatë ditë e Sheh çka ke bërë. Se gabim je, Ti edhe prindi".*

Sipas parashtruesit të ankesës deklarimet e mësipërme përbëjnë shkelje të qarta të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, i cili ndalon përdorimin e gjuhës, deklarimeve apo materialeve që nxisin, provokojnë ose mund të nxisin urrejtje, shpifje apo dëmtim të reputacionit të personave të tjerë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Kodit të Sjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatët, Neni 4 Veprimet e ndaluara, me qëllim ndikimin në vullnetin e votuesit.

Andaj kërkohet nga PZAP që Subjektin Politik PLE, përkatësisht Kryetarin Veton Berisha ta ndëshktojë sipas legjislacionit në fuqi të zbatueshëm për rastin konkret,

Si provë ka bashkangjitur video në CD me pamje dhe audio e cila dëshmon të lartcekurat në këtë ankesë.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur më datë 06.06.2026, nga Subjekti Politik PLE, kanë theksuar në ankesën e paraqitur nga IRDK-ja, është theksuar se më datën 01 Qershor 2025 jemi vënë në dijeni se kryetari i PLE-së Veton Berisha, ka pasur një bisedë private me Ibrahim Haliti, në lidhje me kryetarin e IRDK-së, ku është nxjerrë transkripti i kësaj bisede të paraqitur si në ankesë. Pra, as vet ankuesi nuk është i sigurt nëse ka të drejtë të paraqes ankesë apo jo, në këtë mënyrë i njëjti nuk e cekë në ankesë datën kur ka ndodhi biseda por vetëm ka shkruar se më 01.06.2026 janë vënë në dijeni për atë bisedë, por pa specifikuar qartë se kur ka ndodhur ajo bisedë.

PLE, në tërësi i kundërshton këto pretendime të IRDK-së, sepse këto biseda janë bërë privatisht dhe vetëm me një person, e për më tepër biseda është bërë para fillimit të fushatës zgjedhore, përkatësisht më datën 27.05.2026 pra një ditë para fillimit të fushatës që zyrtarisht ka filluar më 28.05.2026 ndërsa ankesa është paraqitur më 02.06.2026 dhe një ankesë e paraqitur për një bisedë të tillë jashtë fushatës së zgjedhjeve është e pa mbështetur ligjërisht, e pas afatshme dhe si e tillë duhet të hedhet poshtë nga ana e PZAP-it.

Pra, Ligji nr 08/L-228 LZP zbatohet dhe obligon subjektet politike që të sillen në kuadër të këtij ligji vetëm gjatë periudhës të fushatës zgjedhore, që në rastin aktual fushata zyrtarisht ka filluar më 28 Maj 2026, ndërsa biseda private e zhvilluar ndërmjet Veton Berishës me Ibrahim Halitin është bërë më 27 maj 2026 e për të cilën kanë paraqitur ankesë subjekti IRDK më datën 02.06.2026.

Si prove ka bashkangjitur CD me komunikimin e datës 27 Maj 2026.

Në përgjigje ritheksojnë se kjo ankesë është paraqitur ndaj një bisedë private dhe që është zhvilluar jashtë periudhës së fushatës zgjedhore (dhe në asnjë mënyrë kjo nuk duhet të merret parasysh nga ana e PZAP sepse ankesa nuk është e mbështetur në asnjë dispozitë ligjore që e rregullon procesin zgjedhor në Republikën e Kosovës, pra ankuesi nuk ka cekur asnjë dispozitë ligjore që mund të jetë cenuar, por në mënyrë të përgjithësuar vetëm ka cekur Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Si prove kanë bashkëngjitur në ankesë komunikimin e datës data 27.05.2026 të z.Veton Berisha me Ibrahim Halitin, si dhe provat tjera relevante që e vërtetojnë të kundërtën e atyre që pretendon IRDK-ja.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

-Ankesa është e palejuar

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dhe përgjigjes në ankesë të Subjektit Politik PLE, konstatoi se ankesa është parashtruar para afatit ligjor për paraqitjen e ankesës. Në rastin konkret nga provat e prezantuara nga pala ankuese e njëjta thekson se shkelja ka ndodhur me datën 27.05.2026, ndërsa fushata zgjedhore ka filluar më datë 28.05.2026, ndërsa ankesën pala e ka dorëzuar në PZAP me datën 05.06.2026, e që nënkupton se shkelja e supozuar ka ndodhur para hapjes zyrtare të fushatës zgjedhore, të përcaktuar me Planin Operacional të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 07 Qershor 2026.

Me qenë se shkelja e supozuar ka ndodhur më datë 27.05.2026 atëherë pa mëdyshje konstatohet se ankesa është e parakohshme dhe një ankese të tillë duhet hedhur poshtë si te palejueshme e në kuptim te dispozitës së nenit 13.3 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, në PZAP.

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, parashihet që: *“Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara, ndërsa nën paragrafi 5.5 parasheh që: “për shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët”. Mirëpo, shkelja e pretenduar ka ndodhur para fushatës zgjedhore të përcaktuar nga ana e KQZ-së.*

Paneli ka gjetur se ankesa është parashtruar pas afatit të paraparë ligjor dhe duke u bazuar në nenin 39, paragrafi 3 të LZP-së, nenin 9 paragrafi 5 dhe nenin 13 paragrafi 3 pika 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZP.Anr.27/2026, datë 06.06.2026



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.